

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
"SUNRISE 2025"

Në këtë Akt-Themelimi :

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar:

Sot, më datë 24.02.2025 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "SUNRISE 2025", Themeluesit e shoqërisë janë shtetasit:

1. Z. Uke Idriz Çelkolaj i datëlindjes 23.02.1973, lindur në Rragam, Tropojë, dhe banues në, Bregu i Lumit, Nd.124, H.1, Njësia Bashkiake Nr.11, Tiranë, shtetas shqiptar i identifikuar me numër personal (ID) H30223201N.

2. Z. Osman Isuf Kokoshi i datëlindjes 27.05.1969, lindur në Kavajë, Durrës dhe banues në, Rruga Taulantia, Nd.302, H1, Kavajë, shtetas shqiptar i identifikuar me numër personal (ID) G90527037M.

Shoqëri e cila do të funksionojë në bazë të këtij, **AKT-THEMELIMI**.

LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

NENI 1

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është "SUNRISE 2025". Emri tregtar i kësaj Shoqërie është "SUNRISE 2025".

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 2

Objekt i Shoqërisë Tregtare "SUNRISE 2025" është:

Veprimtari në fushën e investimit, investitor në ndërtim, investime strategjike. Ndërtues i objekteve civile industriale, turistike, bujqesore, ndërtimi i ndërtesave, serave, zyrave, rrugeve, hekurudhave, porteve, aeroporteve, veprave energjitike, kanalizimeve dhe çdo veprë tjetër me qëllim ndërtimi. Restaurimi dhe riparimi i godinave dhe objekteve të ndryshme civile. Punime dheu e transport, punime murature, betoni, beton armeje, konstruksione të ndryshme metalike e druri. Punime rrugesh, kanalizimeve, ujesjellesa, urash e veprash arti. Të zhvillojë çdo veprimtari dhe aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shërbime imobiliare. Bar-Restorant-I hoteleri.



KOHËZGJATJA

NENI 3

Shoqëria Tregtare "SUNRISE 2025", do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 4

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare "SUNRISE 2025", e ka vendodhjen e saj në, Kryemëdhenj, Zona Kadastrale 2291, Nr. pasurisë 105/77, Golem, Kavajë.

REGJIMI JURIDIK

NENI 5

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria "SUNRISE 2025" fiton personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "SUNRISE 2025", përbëhet prej 100,000.00 (Një qind mijë) lekë.

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e:

1. Z. Uke Çelkolaj: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Z. Osman Kokoshi: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar është Z. Klajdio Osman Kokoshi me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.



TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur. Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 9

Viti financiar i shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

LIKUJDIMI

NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likujdim e sipër".

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SUNRISE 2025"

Uke Çelkolaj



Osman Kokoshi

